



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr.1135/20
1136/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: “Ac ing” SH.P.K & “A Con” SH.P.K, si dhe OE “BM Group” SH.P.K –Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatorët ekonomik: “GLOBI M.I & EURO CONSTRUCTION”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i ri i stacionit të autobusëve”, me nr. të prokurimit: 651-20-2311-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK GJILAN, më datën: 22.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHEN, pjesërisht të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: “Ac ing” SH.P.K & “A Con” SH.P.K, si dhe OE “BM Group” SH.P.K –Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i ri i stacionit të autobusëve”, me nr. të prokurimit: 651-20-2311-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK GJILAN.

II.ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i ri i stacionit të autobusëve”, me nr. të prokurimit: 651-20-2311-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK GJILAN dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues “Ac ing” SH.P.K & “A Con” SH.P.K, si dhe OE “BM Group” SH.P.K –Prishtinë, aprovohen pjesërisht të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “Ac ing” SH.P.K & “A Con” SH.P.K- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 23.12.2020 me nr. 1135/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i ri i stacionit të autobusëve” , me nr. të prokurimit: 651-20-2311-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK GJILAN , duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet; 61, 6, 7, 59, 60, 64, 69, 72 dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Operatori ekonomik ankues OE “BM Group” SH.P.K –Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 24.12.2020 me nr. 1136/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i ri i stacionit të autobusëve” , me nr. të prokurimit: 651-20-2311-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK GJILAN, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 59, 69, dhe 72, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 30.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 11.01.2021, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

Shqyrtimi i pretendimeve ankimore për OE “Ac ing” SH.P.K & “A Con” SH.P.K

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues thotë se AK-ja nuk ka respektuar vendimin e Panelit shqyrtues me numër 714.718.720.721/20, ku obligon AK-në të kërkojë sqarime shtesë konformë nenit 59.2 dhe nenit 72 të LPP-së dhe të bëjë vlersimin dhe ekzaminimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe thotë se AK-ja na ka eliminuar pa bazë dhe pa kërkuar sqarime shtesë.

Si arsye e eliminimit nga AK-ja për OE ankues është kërkesa 2 tek mundësit teknike dhe/ose profesinale e FDT-së, AK-ja thotë se i mungojnë kontratat e punës, CV, dhe referencat për 4 salduesit ,ndërsa OE ankues thotë se ato ekzistojn dhe po ja deshmojm .(Gjeni te bashkangjitura Kontratat e punës, CV, dhe referencat për 4 salduesit).

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë është: *“Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme4 (Katër) saldues të certifikuar”* Dhe si dëshmi dokumentare është kërkuar: *“Për te gjithë personelin profesional - Për menaxherin e Projektit si dhe Personelin Kryesor Teknik, të paraqiten Diplomat përkatëse te noterizuar , kontratat e punës , CV dhe letër referencë në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit. Një ashtu për salduesit kopja e certifikatës”*

Pas analizimit të dokumentacionit të ofruar në platformën elektronike për këtë aktivitet të prokurimit, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues nuk ka paraqitur dëshmi sa u përket salduesve, edhe pse OE ankues thotë se i gjeni të bashkangjitura kontratat e punës, CV dhe referencat për katër salduesit mirëpo ato nuk janë në E prokurim, andaj pretendimi i OE ankues për këtë pikë është i pa qëndrueshëm për faktin se mungojnë dëshmit konformë FDT-së dhe njoftimit për kontratë.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

Arsyeja e dytë e eliminimit të OE ankues është se nuk ka plotësuar kërkesë e Aneksit 7 të FDT-së lidhur me skelerit mbajtëse.

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se kërkesë e Aneksit 7 ka qenë :

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (cope)	Sasia që ofron ofertuesi
1	Ekskavator	1	
2	ving statik	1	
3	skeleri mbajtëse	Duke u bazuar në projektin e objektit, i cili është bashkangjitur në platformën elektronike	

Për këtë pikë ankimore eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka paraqitur një kontratë mbi qiranë me kompanin N.N“RINIA” – Kaçanik për Marrjen me qira të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe në këtë marrëveshje tek lista e mjeteve gjenden skele të përdorura 1410 copë.

Duke pas parasysh që kërkesa e AK-së nuk është e specifikuarë në më shumë detaje dhe duke pas parasysh që OE ankues ka paraqitur marrëveshje me qera të mjeteve në të cilën evidentohen dhe sasia e skelerive në dispozicion,OE ankues në rubrikën që kërkohet të plotësohet në Aneksin 7 të FDT-së ka thënë: “Skeleri janë sipas kërkesë për projekt”,andaj pretendimi i OE ankues për këtë pikë është i qëndrueshëm.

Pretendimet në vijim të OE “Ac ing” SH.P.K & “A Con” SH.P.K janë për GOE të rekomanduar për kontratë.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

OE ankues pretendon se AK-ja ka shpallur fitues GOE pa ju kërkuar dokumentët e ATK-së dhe gjykatës që duhet të kërkohen para vendimit të AK-së.Sepse vërtetimet e ATK-së janë me afat të skaduar-Globi M.I Sh.p.k, ka Vërtetimin e ATK-së me datë:18.06.2020,kurse BSLIMI MORINA B.I, ka Vërtetimin e ATK-së me datë:10.08.2020.

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se KRPP-ja tek pyetjet e shpeshta ka dhënë një interpretim tek pyetja me numër rëndor 64, ku ndër të tjera thotë:

Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkohen të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë. Këto

dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më pak se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës.....

Kur OE rekomandohet për dhënie të Kontratës, para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-se, nga i njëjti kërkohet dëshmia “Vërtetimi nga ATK” dhe për të qenë “i pranueshëm” OE sipas nenit 65 të LPP-së, duhet të vërtetojë se nuk është në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së.

Andaj eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja është dashur të kërkojë nga OE ankues këto dy dokumente.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 4

OE ankues pretendon që GOE nuk e plotëson kushtin për angazhim të stafit sepse të kërkesat e FDT-së është kërkaur kontrata pune e jo kontrata për tender sepse të gjitha kontrata e stafit janë të lidhura me datë 01.07.2020, kurse njoftimi për kontratë i publikuar në E-PROKURIM është me datë 29.05.2020 .Gjithashtu edhe në listën e bashkangjitur të ATK-së shihet se stafi nuk është i punësuar.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është:

“Operatori ekonomike duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme Menaxher i projektit 1. Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose arkitekturës, me 3 vite përvojë pune pas diplomimit. Personeli kryesor teknik Një inxhinier i dip.i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv – 2 vite përvojë pune pas diplomimit.

Një inxhinier i dip.i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik – 2 vite përvojë pune pas diplomimit.

Një inxhinier i dip.i elektroteknikes – 2 vite përvojë pune pas diplomimit.

Një inxhinier i dip.i makinerisë – 2 vite përvojë pune pas diplomimit.

4 (Katër) saldues të certifikuar” Ndësa si dëshmi dokumentare është kërkuar: Për të gjithë personelin profesional - Për menaxherin e Projektit si dhe Personelin Kryesor Teknik, të paraqiten Diplomat përkatëse të noterizuar , kontratat e punës , CV dhe letër referencë në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit. Një ashtu për salduesit kopja e certifikatës.

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë në listën e stafit të tij profesional ka praqitur kontrata pune për punonjësit të cilët i ka të angazhuar për projektin “Ndërtimi i ri i stacionit të autobusëve”,më tej eksperti sqaron se nuk ka qenë kërkesë decitive e FDT-së që punëtorët duhet të jenë me kontratë pune siç pretendon OE ankues,por në kërkesën të cilën e keni të vendosur më lartë thuhet kontratat e punës,dhe OE i

rekomanduar për kontratë ka paraqitur kontrata të punës për stafin e tij profesional për projektin në fjalë.

Andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa qëndrueshëm për faktin se nuk mund të eliminohet një OE për një kërkesë që nuk ka qenë kërkesë e DT-së dhe njoftimit për kontratë.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 5

OE ankues pretendon që OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar Aneksin 6 të FDT-së lidhur me kontratat si në vijim:

OE "Globi -M.I "Sh.p.k ka paraqitur kontrata me institucione dhe referenca po te gjitha janë të infrastruktures e nuk ka kontrata per ndertimi siç ceket ne kërkesat e FDT-së.

OE "-N.N.P "EURO CONSTRUCTION" Titulli i kontrates: Ndertimi i Aneksit të kuzhines ne kazermen e FSK-se ne Prishtine. (Vlera e kontrates: $(159,817.65 \text{ €} + 14,219.89 \text{ €}) = 174,037.50 \text{ €}$).

7.2 Titulli i kontrates: Ndertimi i objektit të QKRC-QKRA në Istog.(Vlera e kontrates:309,155.18€)-Per kete kontrate eshtë ne konzorcium N.N.P "EURO CONSTRUCTION"& "BENI CONSTRUCTION",prandja kompani N.N.P "EURO CONSTRUCTION" nuk i ka 100% te vleres se kontrates po max.70% te kontrates qe i bjen ne vlerë: 216,408.6€.

7.3 Titulli i kontrates: Ndertimi i objektit të QKRC-QKRA në Istog. (Vlera e kontrates:6,369.46€)-Per kete kontrate eshtë ne konzorcium N.N.P "EURO CONSTRUCTION" & "BENI CONSTRUCTION",prandja kompani N.N.P "EURO CONSTRUCTION" nuk i ka 100% te vleres se kontrates po max.70% te kontrates qe i bjen ne vlerë: 4,458.62€.

Totali i kontratave te realizuara nga N.N.P "EURO CONSTRUCTION" : 412,988.29 €

Prandaj nuk e plotësojnë kushtin e kontratave sipas kërkesës së FDT-së.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: *"Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses se paku 2 kontrata te ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë. vlera,minimale duhet të jetë – 600 000,00 €".Dhe si dëshmi dokumentare është kërkuar: "Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve"*

Anëtari i konzorciumit OE "Globi -M.I "Sh.p.k ka ofruar një listë me 9 projekte të realizuar të kërkuara sipas

FDT-së, mirëpo në listë kontratat ngjasojnë më shumë me natyrën e infrastruktures ku perfshihen punët në rregullimin e oborreve, kubëzim, skajore, mure të betonit, armim etj, dhe kërkesë e FDT-së është që kontratat të jenë të ngjajshme.

Ndërsa sa i përket kontestimit të kontratave të lartëcekura të OE të rekomanduar për kontratë N.N.P "EURO CONSTRUCTION", eksperti shqyrtues sqaron se gjatë rivlersimit AK-ja konformë nenit 59.2 të LPP-së të kërkojë sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë, lidhur me përqindjen e pjesëmarrjes në konzorcium dhe të vërtetojë se e plotëson apo jo kërkesën e FDT-së dhe njoftimit për kontratë.

Pergjigje në pretendimet ankimore të OE "BM Group" SH.P.K –Prishtinë

Pergjigje në pretendimin ankimor 1

Pretendimi i OE ankues ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues nga AK-ja dhe thotë se AK ka shkelur nenin 7, 59 dhe 72 të LPP-së duke na eliminuar me arsyetim se Ing.Shqipe Emini, për diplomën e së cilës ne kemi ofruar diplomën e noterizuar nga zyra komunale në obiliq duke u bazuar në atë se çdo institucion publik ka rëndësinë e njejtë dhe çdo dokument i dalur si zyret komunale, noteriale apo qeveritare ka rëndësinë e njejtë.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: *"Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme Menaxher i projektit 1. Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose arkitekturës, me 3 vite përvojë punë pas diplomimit. Personeli kryesor teknik Një inxhinier i dip.i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv – 2 vite përvojë pune pas diplomimit.*

Një inxhinier i dip.i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik – 2 vite përvojë pune pas diplomimit.

Një inxhinier i dip.i elektroteknikes – 2 vite përvojë pune pas diplomimit.

Një inxhinier i dip.i makinerisë – 2 vite përvojë pune pas diplomimit.

4(Katër) saldues të certifikuar" Ndësa si dëshmi dokumentare është kërkuar: *Për te gjithë personelin profesional - Për menaxherin e Projektit si dhe Personelin Kryesor Teknik, të paraqiten **Diplomat përkatëse te noterizuar** , kontratat e punës , CV dhe letër referencë në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit. Një ashtu për salduesit kopja e certifikatës.*

Pas qasjes në dokumentacionin e ngarkuar në E prokurim, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues për projektin në fjalë ka paraqitur znj.Shqipe Emini si inxhinier e ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknik, për të cilën është ofruar kopja e diplomës e cila është e vulosur nga Drejtoria e përgjithëshme e Administratës së Komunës së Obiliqit dhe nuk është e noterizuar. Ndërsa me Ligjin për Noterin të Kosovës (LIGJI Nr. 06/L-010) vetëm Noterët janë të autorizuar për vërtetimin e dokumentëve.

Për arsyet se pse OE ankues nuk e ka paraqitur diplomën AK-ja konformë nenit 59.2 të LPP-së ka mundur të kërkojë sqarime nga OE ankues.

Pergjigje në pretendimin ankimor 2

OE ankues thotë se per skele mbajtëse ne kemi ofruar marrëveshje për qiradhënjë të skeleve nga kompania "Timo Construction Sh.p.k". Ne nga kompania kemi marrur faturen e blerjes që posedojnë vetë për vinç statik, pasi që AK ka cekur se duhet fatura vetëm për automjete që nuk regjistrohen jo edhe për pajisje, dhe skelet nuk hyjnë në kategorinë e automjeteve që nuk regjistrohen pasi që janë pajisje mbajtëse. Por ne në kerkesën për rishqyrtim kemi ofruar edhe faturat për pajisje-skele. Për fatura që kompania na ka ofruar skelet, për mos shkelur nenet ligjore, AK ka mundur të kërkojë sqarime shtesë. Duke mos kërkuar sqarim shtesë AK ka shkelur LPP, respektivisht Nenin 69 të LPP-së , pika 2 dhe 2.2, pasi që ne kemi ofruar marrëveshjen për shfrytëzimin me qera të skeleve. Po ashtu për sasi të cekur ne e kemi marrur parasysh se është konstatuar sipas projektit nga ana e AK dhe nuk kemi cekur numër specifik.

Pas analizimit te dokumentacionit te ofruar nga OE ankues, ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues ka paraqitur një marrëveshje për qiramarrje me OE "Timo Construction"sh.p.k, për plotësimin e Aneksit 7 të dosjes së tenderit.Marrëveshja ka të bëjë për këto paisje:

Vinç Statik	GRU Raimondi MR 45 Me kupol
Skele Mbajtëse	Skele mbajtëse
Mjete të nevojshme për ndërtim te larte si :	pahi, vibrator dhe mjete tjera të imta.

Këtë pretendim ankimor Paneli Shqyrtues i OSHP-së me nr 714,718,720,721/20, i datës 29.10.202 ka vendosur që: Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlereson se ky pretendim ankimor eshte i bazuar,mirëpo në rast se AK-ja ka paqartesi gjate rivleresimit mund te kerkoj sqarime konform nenit 59.2 dhe nenit 72 të LPP-së.

Andaj duke pas parasysh që në marrëveshje nuk ka qenë shume e detajuar me përshkrimin e skelerive AK-ja ka mundur gjatë rivlersimit të kërkojë sqarime nga OE ankues.

Pergjigje në pretendimin ankimor 3

OE ankues pretendon se AK-ja ka favorizuar GOE "Globi - M.I. SH.P.K.; N.N.P. EURO CONSTRUCTION", ka bërë shkelje të nenit 1 dhe 6 të LPP-së sepse qëllimi i këtij ligji është që AK të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoritetit kontraktuese.GOE "Globi-M.i. SH.P.K.;

N.N.P. EURO CONSTRUCTION", me vlerë të ofertës prej 729,542.20 €, e cila ofertë është më e shtrejtë se sa oferta e jonë "BM Group" Sh.p.k e cila është në vlerë prej 659,986.13 €. Respektivisht ju keni dëmtuar buxhetin e Komunës tuaj si dhe interesin publik me rastin e rekomandimit për kontratë të GOE "Globi - M.I" SH.P.K.; N.N.P. "EURO CONSTRUCTION" në vlerë prej 69,556.07 €.

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se neni 60 i LPP-së lidhur me kriteret për dhënien e kontratës parasheh:

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji.

Në rastin konkret aplikohet pika 1.1 tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, andaj pa u perfunduar e gjithë proceruda e ankesave nuk mund të dijmë se AK-ja cilën ofertë ka zgjedhur në kuptimin administrative të përgjegjshme me çmim më të lirë.

Pretendimet në vijim janë nga OE "BM Group" SH.P.K –Prishtinë për OE tjerë pjesmarrës në procedurë të prokurimit për të cilët OE ankues pajtohet me vendimin e AK-së.

Pergjigje në pretendimin ankimor 4

OE ankues thotë se për GOE të tjerë Autoriteti Kontraktues ka zbatuar ligjin e prokurimit dhe rregulloren duke u mbështetur në nenet dhe në dokumentet që ata si OE nuk i plotësojnë kushtet dhe nuk janë të përgjegjshëm për realizimin e projektit.

Për GOE – "AC ing dhe A Con" Sh.p.k mungojnë: Ne dosjen e ofertuar nga GOE "AC ING SH.P.K; A CON"SH.P.K, komisioni i vlersimit ka konstatuar se ju mungojnë Kontratat, CV, dhe referencat e salduesve ku edhe te certifikata e salduesit Artan Dashi nuk përputhet numri i certifikatës me numrin e verifikimit ku Nr: i Certifikatës është ER-414-0TW ndërsa linku <http://www.easicc.com/erll14qtetraining>.

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se ka dhënë përgjigje më lartë në pretendimin numër 1 tek pergjigjet e OE "Ac ing" SH.P.K & "A Con" SH.P.K.

Pergjigje në pretendimin ankimor 5

Për GOE "Arhiko ING o.p; AL-GROUP" SH.P.K mungojnë: Te Kapaciteti teknik dhe Profesional 9.1&9.2

në Kërkesën 2 sipas FDT është kërkuar që Operatori ekonomike duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të jenë me kualifikime shkollore të mëposhtme, 4 saldues të certifikuar.

Në dosjen e ofertuar nga GOE "Arhiko ING o.p; AL-GROUP" SH.P.K komisioni i vlersimit nga AK ka konstatuar se i mungon validiteti i certifikates së saldimit të z.Musli Sallahu ku kjo certifikat ka pasur vadilitet deri me datë: 15.07 .2019.

Pergjigje në pretendimin ankimor 6

Për GOE "Edona Sh.p.k.; SUVATIMI SH.P.K; Company Murseli SH.P.K" rnungojnë:1.Nje listë të kontratave të realizuara, duke plotesuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumicën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkangjiten referencat ose certifikatat për kryerjen e punëve sipas Aneksit 6 të DT-së.

Në dosjen e ofertuar nga ju si GOE "Edona Sh.p.k.; SUVATIMI SH.P.K; Company Murseli"SH.P.K komisioni i vlerësimit nga AK ka konstatuar se nuk e keni dorëzuar Listën e Kontrateve sipas Aneksit 6 sipas DT.

2. Operatori ekonomik duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore në lemit e më poshtme Menaxher i projektil Inxhinier i diplomuar ndërtimtarisë ose arkitekturës, me 3 vite pervojë pune pas diplomimit.Në dosjen e ofertuar nga ju si GOE "Edona Shp.k.; SUVATIMI SHP.K; Company Murseli SHP.K" komisioni i vlersimit ka konstatuar se ju si GOE keni caktuar Menaxher Projekti z.Elnaim Ymeri ku ky inxhinier ka kontratë me KK Gjilan në projektin Hartimi i Projekteve në infrastrukturën rrugore.

3. Kërkesa numër 4 Operatori ekonomik duhet ti ketë të punësuar min 20 punëtor në Listën e pagave të operatorit ekonomik. Duhet ti dorëzohet original ose kopje e noterizuar. Ne dosjen e ofertuar nga ju si GOE "Edona Sh.p.k.; SUVA TIMI SHP.K; Company Murseli SHP.K" komisioni i vlersimit ka konstatuar se ju si GOE nuk e keni dorezuar listen e pagave për 20 (njëzet) punëtor.

Pergjigje në pretendimin ankimor 7

Për GOE "ARIANI CONSTRUCTION SH.P.K.; ALPING SH.P.K; Enggroup SH.P.K; Arch - Ndertimi SH.P.K

Operatori ekonomike duhet të angazhoj personelin profesional të cilit duhet të ken kualifikimet shkollore të më poshtme: për salduesit e certifikuar të paraqiten Diplomat përkatëse të noterizuar, kontratat e punës, CV dhe letër reference në lëmin e kerkuar e lëshuar nga punëdhënesi.Një ashtu për salduesit kopja e certifikatës e noterizuar. Në dosjen e ofertuar nga ju si OE "ARIANI CONSTRUCTION SHP.K.; ALP ING SHP.K; Enggroup SHP.K; Arch Ndertimi SHP.K"komisioni i vlersimil ka konstatuar se ju si GOE i mungon

validiteti i certifikuesve sepse nuk e kan berië datën e rilesimit ku sipas standardeve ISO cdo certifikat ka datë validiteti 3(tre) vjeqar ku per qdo vitë kërkohet të bëhet riauditimi apo rilesimi i certifikatës ku këto certifikata datën e leshimit e kan me datë 27.11.2018 dhe nuk kanë datë tjetër të rilesimit.

Pergjigje në pretendimin ankimor 8

Per GOE OLI-Hidroterm SH.P.K; FIDOLA SH.P.K.

Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme :

1. Për salduesit e certifikuar të paraqiten Diplomat përkatëse të noterizuar, kontratat e punës, CV dhe letër reference në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësi. Një ashtu për salduesit kopja e certifikatës e noterizuar. Në dosjen e ofertuar nga ju si OE komisioni i vlersimit ka konstatuar se ju mungon validiteti i certifikuesve për Saldator sepse të 4(katër) salduesit e paraqitur kanë afat ne certifiikatat e tvre deri me date: 27.05.2020.
2. Nje inxhinier i dip. I ndërtimtarise drejtimi hidroteknik 2 vite pervojë pune pas diplomimit. Në dosjen e ofertuar nga ju si OE komisioni i vlersimit ka konslatuar se keni angazhuari si ing i Hidroros z.Bujar Gashi ka kualifikim shkollor bsc i Hidros e jo ing i Hidros ku kualifikimet sipas gradave dallon.
3. OE duhet te jete i certifikuar me keto certifikata ISO 9001 2015 valide UNI EN ISO 3834-2 200 valide. Ne dosjen e ofertuar nga ju si OE komisioni i vlersimit ka konstatuar se ju mungon certifikata UNI EN ISO 3834-2 200.
4. Vlora e sigurisë së tenderit 22.000, 000 € .Sigurimi i tenderit duhet të dorezohet i skanuar së bashku me ofertën, ndersa forma origjinale e sigurimit të tenderit do të kërkohet të dorezohet nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shperblej me kontratë. Mos dorezimi i formës origjinale të sigurimit të tenderit shpije në zbatimin e nenit 99.2 te LPP-së. Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë 120 apo muaj Ne dosjen e ofertuar nga ju si OE komisioni i vlersimit ka konstatuar se sigurimi i Tenderit nga ana juaj nuk permbush kerkesen per vlefshmërin e tenderit ku ka veliim 108 ditë pas hapjes së ofertave.

Pergjigje në pretendimin ankimor 9

Për OE - MERCOM Company Sh.p.k

Operatori ekonomik duhet te ofroje deshmi se ka peifunduar me sukses se paku 2 kontrata le ngjajshme ne 3 (tri) vitet e fundit (dukefilluar nga data e publikimit te Njoftimit per kontrate. vlora,minimale duhet te jete - 600 000, 00 € €sipas Aneksit 6 te DT

Ne dosjen e ofertuar ngaju si OE Mercom Company SHP.K komisioni i vlersirnit ka konstatuar se nuke keni dozuar Listen e Kontrateve sipas Aneksit 6 sipas DT.

Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit Paisjet dhe mekanizimi i obligueshem sipas tabelës në Aneksin 7 të DT-së. Në dosjen e ofertuar nga ju si OE Mercom Company SIIP.K kornisioni i vlersimit ka konstatuar se nuk e keni dorzuar Aneksin 7 sipas DT-së.

Pergjigje në pretendimin ankimor 10

Per GOE “NNP Standart SH.P.K; Arifaj” SH.P.K.

1. Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jete: 90 ditë, ose muaj, ose deri ne datën. Në dosjen e ofertuar nga ju si OE komisioni i vlersimit ka konstatuar ju si OE keni ofertuar me periudhe validiteti 6 muaj,

Pergjigje në pretendimin ankimor 11

Për OE “Krap COM” Sh.p.k

1.OE duhet te jete i certifikuar me këto certifikata ISO 9001 2015 valide UNI EN ISO 3834-2 200 valide. Ne dosjen e ofertuar nga ju si OE komisioni i vlersimit ka konstatuar se ju keni ofertuar me certifikatë 9001-2005 në emër të Pharma Start LLC ku mund te vertetohet permes Linkut <https://www.tuev-nord.de/en/company/certification/support/certificate-database/>.

Pergjigje në pretendimin ankimor 12

Per GOE “IR Project, N.N.P.T Engineering; N.N.P ART PROJEKT”

Në dosje të tenderit është kërkuar Vlera e sigurisë së tenderit 22. 000, 000 € Sigurimi i tenderit duhet të dorëzohet i skanuar se bashku me ofertë, ndërsa forma origjinale e sigurimit të tenderit do të kërkohej të dorëzohet nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë. Mos dorezimi i formës origjinale të sigurimit të tenderit shpie në zbatimin e nenit 99.2 të LPP-së.Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë 120 apo muaj. Ne dosjen e ofertuar nga ju si OE komisioni i vlersimit ka konstatuar se ju te Numri i Prokurimit në sigurim të tenderit ju keni gabuar duke shënuar nr. 651-20-2311-521.

1. Per salduesit e certifikuar të paraqiten Diplomat përkatëse të noterizuar, kontratat e punes, CV dhe letër reference në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësi.Një ashtu për salduesit kopja e cerifikatës e noterizuar. Në dosjen e ofertuar nga ju si OE komisioni i vlersimit ka konstatuar se ju te z.Musli Sallahu ku kjo certifikat ka pasur vadilitet deri me date: 15.07.2019.

Pergjigje në pretendimin ankimor 13

Për OE-OLTI Trasing Sh.p.k

Operatori Ekonomik duhet te angazhoj personelin profesional të cilit duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme: për salduesit e certifikuar të paraqiten Diplomat përkatëse të noterizuar, kontratat e punës, CV dhe leter reference në lëmin e kerkuar e lëshuar nga punëdhënësi. Nje ashtu për salduesit kopja e certifikates e noterizuar. Në dosjen e ofertuar nga ju si OE komisioni i vlersimit ka konstatuar se ju si GOE i mungon validiteti i certifikuesve sepse nuk e kan bërë datën e rilëshimit ku sipas standardeve ISO cdo certifikat ka afat validiteti 3(tre) vjeqar ku për çdo vitë kërkohet të bëhet riauditimi apo rilesimi i certifikatës ku këto certifikata datën e lëshimit e kan me datë 27.11.2018 dhe nuk kanë datë tjetër të rilëshimit.

Pretendimet ankimore të OE **“BM Group” SH.P.K–Prishtinë** me numër rëndor 5,6,7,8,9,10,11,12 dhe 13 për të cilat OE ankues **“BM Group” SH.P.K –Prishtinë** pajtohet me arsyet e eliminimit nga AK-ja për operatororët tjerë, eksperti shqyrtues sqaron se të gjithë OE kanë marrë përgjigje në letrat standarde lidhur me arsyet e eliminimit, dhe disa prej tyre kan bërë kërkesë për rishqyrtim dhe kanë pranuar përgjigje nga AK-ja.

Andaj për faktin se OE të lartpërmendur nuk kanë paraqitur ankesë në OSHP, në një formë apo tjetër janë pajtuar me vlersimin e Autoritetit Kontraktues.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE **“Ac ing” SH.P.K & “A Con” SH.P.K**, si dhe OE **“BM Group” SH.P.K –Prishtinë** të aprovohen si pjesërisht të bazuar, të anulohet njoftimi për vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe lënda të kthehet në **rivlerësim**.

Autoriteti Kontraktues me datë: 11.01.2021 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **NUK PAJTOHET** me mendimi e ekspertit shqyrtues andaj presim nga paneli shqyrtues –oshp qe ne nje afat kohor te caktohet seanca kryesore dhe te njoftohet AK me vendimin e panelit shqyrtues.

Operatori Ekonomik- **“Ac ing” SH.P.K & “A Con” SH.P.K**, me datë: 13.01.2021, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **NUK PAJTOHET** me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Pasi kemi pranua e-mail me datë: 11.01.2021, ora 12:48 nga OSHP-ja ku ne e-mail është bashkangjitur raporti i ekspertit me numer :1135-1136/20 dhe është kërkuar të japim një përgjigje për këtë raport se pajtohemi apo nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit.

Ne nuk pajtohem me mendimin e ekspertit ku në raportë ekashenuarë përgjigja në pretendimin tonë ankimore per piken 1 :

Pas analizimit të dokumentacionit të ofruar në platformën elektronike për këtë aktivitet të prokurimit, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues nuk ka paraqitur dëshmi sa u përket salduesve, edhe pse OE ankues thotë se i gjeni të bashkangjitura kontratat e punës, CV dhe referencat për katër salduesit mirëpo ato nuk janë në E prokurim, andaj

pretendimi i OE ankues për këtë pikë është i pa qëndrueshëm për faktin se mungojnë dëshmit konformë FDT-së dhe njoftimit për kontratë,

Ju njoftojmë se ne e kemi ngarkuar ne e-prokurim se bashku me dokumentet tjera dhe kjo gjendet ne e-prokurimi me emrin:Fajlli është i zip- **Dokumenete-1 ;brenda fajllit zip gjendet dokumenti - CV.Kontrata e puntorve,Referencat .Eksperti** ka pasur dëshmi të mjaftueshme që të propozon të panelit shqyrtues i OSHP-së ne si GOE si i plotësojmë të gjitha kushtet në bazë të njoftimit për kontratë dhe në bazë të FDT-së .

Prandaj kërkojmë nga paneli shqyrtues i OSHP-së të njerr vendim të qartë ku ne të shpallemi fitues si GOE me çmim më të ultë dhe ta hudh poshtë propozimin e ekspertit për rivlerësim.

Operatori Ekonomik **“BM Group” SH.P.K –Prishtinë** me datë: 12.01.2021, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP se **PAJTOHET** me mendimin e ekspertit shqyrtues,

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 22.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Përgjigje lidhur me pretendimet ankimore të OE “Ac ing” SH.P.K & “A Con” SH.P.K

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues ku thotë se AK-ja nuk ka respektuar vendimin e Panelit shqyrtues me numër Psh.nr 714.718.720.721/20, që obligon AK-në të kërkojë sqarime shtesë konformë nenit 59.2 dhe nenit 72 të LPP-së dhe të bëjë vlerësimin dhe ekzaminimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe thotë se AK-ja na ka eliminuar pa bazë dhe pa kërkuar sqarime shtesë. Si arsye e eliminimit nga AK-ja për OE ankues është kërkesa 2 tek mundësit teknike dhe/ose profesionale të FDT-së,AK-ja thotë se i mungojnë kontratat e punës,CV,dhe referencat për 4 salduesit ,ndërsa OE ankues thotë se ato ekzistojnë dhe po ja dëshmojmë .(Gjeni të bashkangjitura Kontratat e punës, CV, dhe referencat për 4 salduesit).

Paneli shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: *“Operatori ekonomike duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme4 (Katër) saldues të certifikuar”* dhe si dëshmi dokumentare është kërkuar: *“Për të gjithë personelin profesional - Për menaxherin e Projektit si dhe Personelin Kryesor Teknik, të paraqiten Diplomat*

përkatëse te noterizuar, kontratat e punës, CV dhe letër referencë në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit. Një ashtu për salduesit kopja e certifikatës”. Paneli shqyrtues sqaron se OE ankues nuk ka paraqitur dëshmi sa u përket salduesve, edhe pse OE ankues ka deklaruar se i gjeni të bashkangjitura kontratat e punës, CV dhe referencat për katër salduesit mirëpo ato nuk janë në sistemin e e-prokurimit, andaj pretendimi i OE ankues për këtë pikë është i pa qëndrueshëm për faktin se mungojnë dëshmitë konformë FDT-së dhe njoftimit për kontratë.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues për arsyen e dytë e eliminimit se nuk ka plotësuar kërkesën e Aneksit 7 të FDT-së lidhur me skelerit mbajtëse.

Paneli shqyrtues sqaron se kërkesë e Aneksit 7 ka qenë :

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (copë)	Sasia që ofron ofertuesi
1	Ekskavator	1	
2	Vinq statik	1	
3	Skeleri mbajtëse	Duke u bazuar në projektin e objektit, i cili është bashkangjitur në platformën elektronike	

Paneli shqyrtues sqaron se OE ankues ka paraqitur një kontratë mbi qiranë me kompaninë N.N“RINIA” – Kaçanik për Marrjen me qira të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe në këtë marrëveshje tek lista e mjeteve gjenden skele të përdorura 1410 copë. Duke pas parasysh që kërkesa e AK-së nuk është e specifikuarë në më shumë detaje dhe duke pas parasysh që OE ankues ka paraqitur marrëveshje me qera të mjeteve në të cilën evidentohen dhe sasia e skelerive në dispozicion, OE ankues në rubrikën që kërkohet të plotësohet në Aneksin 7 të FDT-së ka thënë: “Skeleri janë sipas kërkesë për projekt”, paneli shqyrtues vlerëson se kërkesa e dosjes së tenderit është plotësuar nga OE ankues dhe pretendimi ankimor në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Në lidhje me pretendimet ankimore të OE “Ac ing” SH.P.K & “A Con” SH.P.K për OE të rekomanduar për kontratë, paneli shqyrtues sqaron:

OE ankues pretendon se AK-ja ka shpallur fitues GOE pa ju kërkuar dokumentët e ATK-së dhe gjykatës që duhet të kërkohen para vendimit të AK-së. Sepse vërtetimet e ATK-së janë me afat të skaduar-Globi M.I Sh.p.k, ka Vërtetimin e ATK-së me datë:18.06.2020, kurse BİSLIMI MORINA B.I, ka Vërtetimin e ATK-së me datë:10.08.2020.

Paneli shqyrtues sqaron se KRPP-ja tek pyetjet e shpeshta ka dhënë një interpretim tek pyetja me numër rëndor 64, ku ndër të tjera thuhet:

Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkojnë të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblejë me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më pak se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës.....

Kur OE rekomandohet për dhënie të Kontratës, para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, nga i njëjti kërkojnë dëshmia “Vërtetimi nga ATK” dhe për të qenë “i pranueshëm” OE sipas nenit 65 të LPP-së, duhet të vërtetojë se nuk është në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së.

Andaj duke u bazuar në interpretimin e dhënë nga KRPP, paneli shqyrtues vlerëson se AK-ja është dashur të kërkojë nga OE ankues këto dy dokumente.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues që GOE nuk e plotëson kushtin për angazhim të stafit sepse të kërkesat e FDT-së është kërkaur kontrata pune e jo kontrata për tender sepse të gjitha kontratat e stafit janë të lidhura me datë 01.07.2020, kurse njoftimi për kontratë i publikuar në E-PROKURIM është me datë 29.05.2020 .Gjithashtu edhe në listën e bashkangjitur të ATK-së shihet se stafi nuk është i punësuar.

Paneli shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: *“Operatori ekonomike duhet të angazhojë personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme Menaxher i projektit 1. Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose arkitekturës, me 3 vite përvojë pune pas diplomimit. Personeli kryesor teknik Një inxhinier i dip.i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv – 2 vite përvojë pune pas diplomimit.*

Një inxhinier i dip.i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik – 2 vite përvojë pune pas diplomimit.

Një inxhinier i dip.i elektroteknikës – 2 vite përvojë pune pas diplomimit.

4 (Katër) saldues të certifikuar” Ndësa si dëshmi dokumentare është kërkuar: Për të gjithë personelin profesional - Për menaxherin e Projektit si dhe Personelin Kryesor Teknik, të paraqiten Diplomat përkatëse të noterizuar, kontratat e punës, CV dhe letër referencë në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit. Një ashtu për salduesit kopja e certifikatës.

Paneli shqyrtues sqaron se OE i rekomanduari për kontratë në listën e stafit të tij profesional ka praqitur kontrata pune për punonjësit të cilët i ka të angazhuar për projektin “Ndërtimi i ri i stacionit të autobusëve”, dhe se nuk ka qenë kërkesë decitive e FDT-së që punëtorët duhet të jenë me kontratë pune siç pretendon OE ankues, por në kërkesën të cilën e keni të vendosur më lartë thuhet kontratat e punës dhe OE i rekomanduar për kontratë ka paraqitur kontrata të punës për stafin e tij profesional për projektin në fjalë. Andaj, pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa qëndrueshëm për faktin se nuk mund të eliminohet një OE për një kërkesë që nuk ka qenë kërkesë e DT-së dhe njoftimit për kontratë.

Në lidhje me pretendimin ankimor se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar Aneksin 6 të FDT-së lidhur me kontratat si në vijim: OE "Globi -M.I "Sh.p.k ka paraqitur kontrata me institucione dhe referenca po te gjitha janë të infrastruktures e nuk ka kontrata per ndertimi siç ceket ne kërkesat e FDT-së. OE "-N.N.P "EURO CONSTRUCTION" Titulli i kontrates: Ndertimi i Aneksit të kuzhines ne kazermen e FSK-se ne Prishtine. (Vlera e kontrates: (159,817.65 €+14,219.89€= 174,037.50€). 7.2 Titulli i kontrates: Ndertimi i objektit të QKRC-QKRA në Istog.(Vlera e kontrates:309,155.18€)-Per kete kontrate eshtë ne konzorcium N.N.P "EURO CONSTRUCTION"& "BENI CONSTRUCTION", prandaj, kompania N.N.P "EURO CONSTRUCTION" nuk i ka 100% te vleres se kontrates po max.70% te kontrates qe i bjen ne vlerë: 216,408.6€.

7.3 Titulli i kontrates: Ndertimi i objektit të QKRC-QKRA në Istog. (Vlera e kontrates:6,369.46€)-Per kete kontrate eshtë ne konzorcium N.N.P "EURO CONSTRUCTION" & "BENI CONSTRUCTION",prandja kompani N.N.P "EURO CONSTRUCTION" nuk i ka 100% te vleres se kontrates po max.70% te kontrates qe i bjen ne vlerë: 4,458.62€. Dhe se, totali i kontratave te realizuara nga N.N.P "EURO CONSTRUCTION" : 412,988.29 €, prandaj nuk e plotësojnë kushtin e kontratave sipas kërkesës së FDT-së.

Paneli shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: *“Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses se paku 2 kontrata te ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë. vlera, minimale duhet të jetë – 600 000,00 €”*. Dhe si dëshmi dokumentare është kërkuar: *“Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve”*

Anëtar i konzorciumit OE "Globi -M.I "Sh.p.k ka ofruar një listë me 9 projekte të realizuar të kërkuara sipas FDT-së, mirëpo në listë kontratat ngjasojnë më shumë me natyrën e infrastruktures ku perfshihen punët në rregullimin e oborreve, kubëzim, skajore, mure të betonit, armim etj, dhe kërkesë e FDT-së është që kontratat të jenë të ngjajshme.

Ndërsa sa i përket kontestimit të kontratave të lartëcekura të OE të rekomanduar për kontratë N.N.P "EURO CONSTRUCTION", paneli shqyrtues sqaron se gjatë rivlersimit AK-ja konformë nenit 59.2 të LPP-së të kërkojë sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë, lidhur me përqindjen e pjesëmarrjes në konzorcium dhe të vërtetojë se e plotëson apo jo kërkesën e FDT-së dhe njoftimit për kontratë.

Pergjigje në pretendimet ankimore të OE të dytë ankues “BM Group” SH.P.K –Prishtinë

Lidhur me pretendimin ankimor që ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues nga AK-ja dhe thotë se AK ka shkelur nenin 7, 59 dhe 72 të LPP-së duke na eliminuar me arsyetim se Ing.Shqipe Emini ,për

diplomën e së cilës ne kemi ofruar diplomën e noterizuar nga zyra komunale në Obiliq duke u bazuar në atë se çdo institucion publik ka rëndësinë e njejtë dhe çdo dokument i dalur si zyret komunale, noteriale apo qeveritare ka rëndësinë e njejtë, paneli shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: *“Operatori ekonomike duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme Menaxher i projektit 1. Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose arkitekturës, me 3 vite përvojë punë pas diplomimit. Personeli kryesor teknik Një inxhinier i dip.i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv – 2 vite përvojë pune pas diplomimit.*

Një inxhinier i dip.i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik – 2 vite përvojë pune pas diplomimit.

Një inxhinier i dip.i elektroteknikes – 2 vite përvojë pune pas diplomimit.

Një inxhinier i dip.i makinerisë – 2 vite përvojë pune pas diplomimit.

4(Katër) saldues të certifikuar” Ndësa si dëshmi dokumentare është kërkuar: Për të gjithë personelin profesional - Për menaxherin e Projektit si dhe Personelin Kryesor Teknik, të paraqiten Diplomat përkatëse të noterizuar, kontratat e punës, CV dhe letër referencë në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit. Një ashtu për salduesit kopja e certifikatës.

Pas qasjes në dokumentacionin e ngarkuar në E prokurim, paneli shqyrtues konfrom ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues për projektin në fjalë ka paraqitur znj.Shqipe Emini si inxhinierë e ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknik, për të cilën është ofruar kopja e diplomës e cila është e vulosur nga Drejtoria e përgjithëshme e Administratës së Komunës së Obiliqit dhe nuk është e noterizuar.Ndërsa me Ligjin për Noterinë të Kosovës (LIGJI Nr. 06/L-010) vetëm Noterët janë të autorizuar për vërtetimin e dokumentëve. Për arsyet se pse OE ankues nuk e ka paraqitur diplomën AK-ja konformë nenit 59.2 të LPP-së ka mundur të kërkojë sqarime nga OE ankues.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se për skele mbajtëse ne kemi ofruar marrëveshje për qiradhënjë të skeleve nga kompania “Timo Construction Sh.p.k”. Ne nga kompania kemi marrur faturen e blerjes që posedojnë vetë për vinç statik, pasi që AK ka cekur se duhet fatura vetëm për automjete që nuk regjistrohen jo edhe për pajisje, dhe skelet nuk hyjnë në kategorinë e automjeteve që nuk regjistrohen pasi që janë pajisje mbajtëse. Por ne në kërkesën për rishqyrtim kemi ofruar edhe faturat për pajisje-skele. Për fatura që kompania na ka ofruar skelet, për mos shkelur nenet ligjore, AK ka mundur të kërkojë sqarime shtesë. Duke mos kërkuar sqarim shtesë AK ka shkelur LPP, respektivisht Nenin 69 të LPP-së, pika 2 dhe 2.2, pasi që ne kemi ofruar marrëveshjen për shfrytëzimin me qera të skeleve. Po ashtu për sasi të cekur ne e kemi marrur parasysh se është konstatuar sipas projektit nga ana e AK dhe nuk kemi cekur numër specifik.

Pas analizimit të dokumentacionit të ofruar nga OE ankues, paneli shqyrtues sqaron se OE ankues ka paraqitur një marrëveshje për qiramarrje me OE “Timo Construction”sh.p.k, për plotësimin e Aneksit 7 të

dosjes së tenderit. Marrëveshja ka të bëjë për këto paisje:

Vinq Statik	GRU Raimondi MR 45 Me kupoll
Skele Mbajtëse	Skele mbajtëse
Mjete të nevojshme për ndërtim të lartë si :	pahi, vibrator dhe mjete tjera të imta.

Në vendimin paraprak paneli shqyrtues ka deklaruar se nëse AK ka dilema mund të kërkojë sqarime shtesë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së, andaj duke pas parasysh që në marrëveshje nuk ka qenë shume e detajuar me përshkrimin e skelerive AK-ja ka mundur gjatë rivlersimit të kërkojë sqarime nga OE ankues.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se AK-ja ka favorizuar GOE "Globi - M.I. SH.P.K.; N.N.P. EURO CONSTRUCTION", ka bërë shkelje të nenit 1 dhe 6 të LPP-së sepse qëllimi i këtij ligji është që AK të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoritetit kontraktues. GOE "Globi-M.I. SH.P.K.; N.N.P. EURO CONSTRUCTION", me vlerë të ofertës prej 729,542.20 €, e cila ofertë është më e shtrejtë se sa oferta e jonë "BM Group" Sh.p.k e cila është në vlerë prej 659,986.13 €. Respektivisht ju keni dëmtuar buxhetin e Komunës tuaj si dhe interesin publik me rastin e rekomandimit për kontratë të GOE "Globi - M.I." SH.P.K.; N.N.P. "EURO CONSTRUCTION" në vlerë prej 69,556.07 €.

Paneli shqyrtues sqaron se neni 60 i LPP-së lidhur me kriteret për dhënien e kontratës parasheh: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; dhe, 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji.

Në rastin konkret aplikohet pika 1.1 tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, andaj pa u perfunduar e gjithë proçedura e ankesave nuk mund të dijme se AK-ja cilën ofertë ka zgjedhur në kuptimin administrative të përgjegjshme me çmim më të lirë.

Ndërkaq për OE të tjerë operatori ekonomik ankues ka deklaruar se Autoriteti Kontraktues ka zbatuar ligjin e prokurimit dhe rregulloren duke u mbështetur në nenet dhe në dokumentet që ata si OE nuk i plotësojnë kushtet dhe nuk janë të përgjegjshëm për realizimin e projektit. Andaj pasi që OE të lartëpërmendur nuk kanë paraqitur ankesë në OSHP, në një formë apo tjetër janë pajtuar me vlersimin e Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues vlerëson se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së. Paneli shqyrtues konstaton se AK duhet të kërkojë sqarime shtesë konform nenit 72 në të gjitha pikat ku paneli shqyrtues ka konstatuar se AK mund të kërkojë sqarime shtesë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – “KK GJILAN”

1x1 OE – “Ac ing” SH.P.K & “A Con” SH.P.K, si dhe OE “BM Group” SH.P.K –Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.